



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Opština Istok
Istok Municipality

12 Nr 33/2022

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Direkcija za Kulturę Omladinu i Sport

Department of Culture Youth and Sports

Istog, më 25.05.2022

Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, bazuar në nenin 3 paragrafi 1 dhe 2, neni 4 dhe neni 5 të Udhëzimit Administrativ Nr.11/2010 për Licencimin e Qendrave Rinore i nxjerr nga Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport shpallë:

THIRRJE PUBLIKE

PËR APLIKIM PËR LICENSIM SI QENDRA RINORE

Njoftohen të gjitha OJQ-të lokale të cilat fushëveprimtarinë kryesore e realizojnë në sektorin e Rinisë që kanë të drejtë aplikimi për licensim si qendra rinore.

Kërkesës për licensim duhet bashkangjiten dokumentet si në vijim:

- Kërkesa për Licencim të Qendrës Rinore Publike (QRP);
- Certifikatë e vlefshme e regjistrimit si OJQ e regjistruar pranë Ministrisë së

Administratës Publike (MAP);

- Statuti i Organizatës;
- Plan i punës dhe programi së paku për tre vite;
- Raportet e aktiviteteve të më parshme dhe hapësira e veprimtarisë;
- Biografite e personelit menaxhues të OJQ-së;
- Dëshmi mbi strukturën organizative të brendshme dhe funksionimin e Kuvendit të

Anëtarëve.

Qendra për tu licencuar nga komuna përkatëse duhet ti plotësojë këto kushte:

- Duhet të ketë hapsirë të mjaftueshme për aktivitet, së paku 80 m²;
- Marrëveshje mbi shfrytëzimin e hapsirës/truallit/objektit për periudhën që kërkon ti licencohet;
- Personeli menaxhues, personeli edukativ dhe mirëmbajtës;
- Shërbime dhe aktivitete të specifikuara;
- Struktura vullnetare, regjistri i anëtarëve;
- Koha e operimit (orari i punës);
- Numër të konsiderueshëm të të rinjve që marrin pjesë në aktivitet.

Thirrja mbetet e hapur nga data 25.05.2022 deri me datën 17.06.2022.

Aplikacionet e kompletuara mund të dorëzohen, në adresën e mëposhtme:

Komuna e Istogut

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Zyra Qendra për shërbim me qytetarë (QSHQ)

Vërejtje:

Kërkesat e arritura pas datës nuk do të shqyrtohen, kurse dokumenti i pakompletuar do të refuzohet.

Formularin e aplikimit do e merrni në zyren e QSHQ(qendra për shërbim me qytetarë)

Kontrata për Udhëheqjen e Qendrës Rinore do të jetë 3 vjeçare.

Hapësira e dedikuar për licencim si qendër rinore do të jetë në shtëpinë e kulturës në katin e tretë(3).

Dokumentacioni dorëzohet në QSHQ, në zyren ku bëhet pranimi I kërkesave.

Për çdo informatë dhe për të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: eliane.blakaj@rks-gov.net

Drejtoreshë në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport

Eliane Blakaj

